



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.212, Datë 08.10.2021

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT DEPA COMMERCIAL S.A. PËR
APLIKIM NË TAP AG PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG TESTI I TAP
AG PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN**

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neneve 13; 15, pika 1, gërma “a”; 16, pika 24, 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; vendimit nr. 122, datë 11.05.2021, të bordit të ERE-s “Mbi miratimin e Propozimit të Projektit TAP, SRG dhe DESFA për Procesin e Rritjes të Kapacitetit për vitin 2019”; seksionit 4.7, pika 9, e “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë”, Korrik 2013; Opinionit 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 Maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktiva 2009/73/EC nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 08.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 129/6 prot., datë 06.10.2021 nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Miratimin e Kërkesës së subjektit Depa Commercial s.a, për aplikim në TAP AG për fazën jo të detyrueshme në treg-testi i TAP AG”,

Konstatohet se:

- DEPA COMMERCIAL S.A paraqiti në ERE “Kërkesën për aplikim nga DEPA COMMERCIAL S.A për fazën jo të detyrueshme në treg -testi i TAP AG, në përputhje me nenin 4.7, pika 9 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë dhe Direktivën 2003/55/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 Janar 2003 lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror;
- TAP AG sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues / lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar Njoftimit të fazës jo detyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara për lidhjet/kapacitet jo detyrues duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 Tetor 2021.
- Faza jo detyruese e testimit të tregut për vitin 2021 nga Gazsjellësi Trans Adriatik ka filluar në 12 Korrik 2021. Testi i Tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), Greke (RAE) dhe Shqiptare (ERE);
- Depa Commercial S.A. shprehet se është në fazën paraprake jo të detyrueshme të përcjelljes të aplikimit/kërkesës për fazën jo të detyrueshme, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG.
- Kërkesa për aplikim nga Depa Commercial S.A. është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, si të përcaktuara në paragrafin 4.7 të tij, Njoftimi i Fazës Jo-detyruese për Testin e Tregut TAP AG 2021/ Në përputhje me Udhëzimet për Testin e Tregut të 2021, të Gazsjellësit Trans Adriatik, Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit, legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të Miratojë *“Kërkesën e subjektit Depa Commercial S.A. për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në Treg - Testi i TAP AG për kapacitetin dhe lidhjen”.*
2. Drjetoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI